



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NR. AKTI 12
04.05.2020

NR. VENDIMI 9
04.05.2020

VENDIM

“Per zgjatjen e afatit te sekuestrimit”

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e përbërë prej:

Gjyqtare - MILIANA MUÇA

asistuar nga sekretare seance gjyqësore Jerina Sktrapari, në dhomë këshillimi, sot në dt.04.05.2020, ora 12:30 mori në shqyrtim kërkesën me nr.regj.themeltar 12, datë 04.05.2020, që i përket:

KËRKUES: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e përfaqësuar në paraqitjen e kërkesës nga prokurori Altin Dumani.

OBJEKTI: Zgjatjen e afatit të masës së sekuestrimit të pasurisë, të lidhur me procedimin pasuror ndaj shtetasit A.B.

BAZA LIGJORE: Neni 12, pikat (3) dhe (4) të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

Gjykata, pasi shqyrtoi në dhomë këshillimi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe aktet bashkëngjitur,

VEREN

I. Rrethana të faktit dhe pretendimet e prokurorit

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, më datë 31.05.2019, ka regjistruar procedimin penal nr.122, të vitit 2019, për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a, 287, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, në bazë të kërkesës për hetime të bërë nga autoritetet e hetimit penal në Danimarkë.

Më datë 31.05.2019, është depozituar kërkesa për fillimin e hetimeve ardhur nga Autoritetet e Drejtësisë Daneze, nëpërmjet Oficerit Ndërlidhës të Vendeve Nordike këtu në Tiranë, më datë 31.05.2019. Mbi këtë kërkesë dhe material është regjistruar procedimi procedimi penal

nr.122/2019.

Nga materialet e përcjella nga autoritetet daneze të drejtësisë, ka rezultuar se është duke u kryer një hetim proaktiv ndaj disa shtetasve shqiptarë me banim në Danimarkë dhe jashtë saj, dhe ndër ta janë shtetasit **S.K, E.P, D.B, A.D**, etj, të cilët dyshohen si autorë të veprave penale të trafikimit të narkotikëve, pastrimit të produkteve të veprës penale, të kryera në kuadër të një grupi të strukturuar kriminal, që operon jo vetëm në territorin e Danimarkës, por dhe në Gjermani, Hollandë, Suedi, Belgjikë, Shqipëri, etj.

Gjatë hetimit të autoriteteve daneze, janë përfutur të dhëna që krijojnë dyshime të arsyeshme se një pjesë e fitimit nga veprimtaria kriminale e organizuar e trafikimit dhe shpërndarjes së narkotikëve në Danimarkë është investuar në Shqipëri, konkretisht në blerjen e pasurive të paluajtshme etj.

Prokuroria pranë Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, ka regjistruar në datën 19.09.2019 procedimin pasuror nr.9, në ngarkim të shtetasve: J.K (alias S.K), A.B, E.P alias E.E, D.B alias D.E , I.K , A.K , B.E, Y.E etj. Me krijimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ky procedim pasuror, për kompetencë lëndore, vazhdon të ndiqet nga Prokuroria e Posaçme.

Lidhur me këtë procedim pasuror, me vendimin nr.13, date 26.09.2019 Gjykata për Krime të Rënda Tirane, ka vendosur:

“ **I.** Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

II. Sekuestrimin e pasurive si më poshtë:

- Pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, veprimtarinë e personit juridik **XXXX XXXXX SHPK, me numër Nipti LXXXXXXXXR**, me ortak të vetëm shtetasin **A.B**, e ndërtuar një **XXXXXX**.

- **Automjetin** tip “**Volswagen Golf**”, me targë **AA XXX VH**, numër shasie **XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX**;

- **Automjetin tip furgon** ngjyrë e verdhë, i markës **IVECO**, me targa **AA XXX FB**.

- **Automjetin BMW X5** me targë **AA XXX LJ**, numër shasie **XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX**,

- Automjetin tip **Benz Mercedes E320CDI** me targë **AA XXX LG**, numer shasie **XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX**.

- **Një furgon i markës ATP, Damler Chrysler**, ngjyrë e bardhë, me targa **AA xxx RF**.

- **Pasurinë me numër 5xx+1-xx**, me vendndodhje **XXXXXXXXXX** në Zonën Kadastrale **xxxx**, Vol.x, Faqe 44, me sipërfaqe **65 m2** së bashku me katin sipër, me sipërfaqe ndërtimi **70.61m2** e dërguar për legalizim në Zyrën e **ALUZINIT Shkodër** me numër kodi unik **10-xxxxxxx**, të cilat janë në emrin e shtetasve **A.B** dhe **A.K**.

- **Pasurinë me numër 5xx+1-xx**, me vendndodhje **XXXXXXXXXX**, në Zonën

Kadastrale xxxx, Vol.x, Faqe 44, me sip.65 m2 së bashku me katin sipër, me sipërfaqe ndërtimi 71.02m2 e dërguar për legalizim në Zyrën e ALUZINIT Shkodër me numër prot 9899, datë 28.01.2015, të cilat janë në emrin e shtetasve A.B dhe A.K.

- Sasinë prej prej 173.500 euro dhe 8 629 000 lekë, të gjetura gjatë kontrollit të banesës së shtetasit nën hetim A.B, me datë 26.06.2019, në gjendje KESH në shtëpi.

- Pasurinë me numër 5XX+1-X me vendodhje xxxxxxxxxxxxxxxx, në Zonën Kadastrale xxxx, Vol.x, Faqe 42, me sip.65 m2 së bashku me katin sipër, me sipërfaqe ndërtimi 67.84m2, e dërguar dhe legalizuar në Zyrën e ALUZINIT Shkodër me datë 28.02.2018, duke e njohur me numër pasurie 5XX+1-X/1, të cilat janë në emrin e shtetasës I.K.

- Pasurinë me numër 5XX +1-xme vendodhje xxxxxxxxxxxxxxxx, në Zonën Kadastrale xxxx, Vol.x, Faqe 41, me sip.64 m2 së bashku me katin sipër, me sipërfaqe ndërtimi 73.20m2, e dërguar për legalizim në Zyrën e ALUZINIT Shkodër me 06.01.2015, me numër 7860 prot, të cilat janë në emrin e shtetasës Y.E.

- Pasurinë me numër 5xx+1-xx me vendodhje xxxxxxxxxxxxxxxx, në Zonën Kadastrale xxxx, Vol.x, Faqe 49, me sip.65 m2 së bashku me katin sipër, me sipërfaqe ndërtimi 73.20m2, e dërguar dhe legalizim në Zyrën e ALUZINIT Shkodër në vitin 2018, të cilat janë në emrin e shtetasit B.E.

- Apartamentin Nr.1, kati i 7 (shatë), me vendodhje rruga "XXXXXXXXXXXX", në Shkodër, me sipërfaqe banimi 114.27m2, porositur nga shtetasi A.E, më datë 26.01.2017, sipas kontratës së porosisë me Kompaninë "XX" SHPK.

- Sasinë prej 15 mijë euro të gjetura KESH në banesën e shtetasit A.E, me datë 26.06.2019.

- Automjetin tip "BMW" me targa AA XXX TR në pronësi të shtetasit nën hetim E.E alas P.

- Automjetin tip "BMW", me targa AA XXX GY, në pronësi të shtetasit D.E alis **Bech.**

III. Për Administrimin e pasurive të sekuestruara ngarkohet Z. Skënder Met'Hasani, administrator në Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

IV. Urdhërohet pezullimi i pasojave të zbatimit të masës të sekuestrimit, deri në dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e masës së sekuestros, vetëm për ato pasuri për të cilat është vendosur për llogari të procedimit penal sekuestro preventive me vendimin nr. 310 datë 25.06.2019 të Gjykatës për Krime të Rënda.

V. Ky vendim është i ekzekutueshëm menjëherë nga prokurori dhe oficerët policisë gjyqësore të kërkuar prej tij, Leonard Qorri dhe Altin Curri.

VI. Urdhërohet sekretaria gjyqësore e kësaj gjykate t'i dërgoje menjëhere dy kopje të këtij vendimi prokurorëve Donika Prela dhe Anton Martini.

VI. Kundër këtij mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit, në

Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda (*citim*).

Me vendimin nr. 310 datë 25.06.2019 të gjyqtarit të hetimit paraprak të procedimit penal 122/2019 të regjistruar nga Prokuroria për Krime të Rënda, është vendosur:

“Vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë, si më poshtë vijon:

- Mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të kompanisë “XXXX XXXXX”, me numër NIPTI XXXXXXXXXXXX, me vendodhje xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx Shkodër, si dhe mbi magazinën në emrin e saj në Tiranë, me adresë; Xxxxxxxxxx, godina Nr. 4, kati përdhe, dyqani nr. 2.

- Motorr tip “Motorr Yamaha”, me targe SH XXX E, me numer shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX.

- Automjet tip BMË X5, me targe AA XXX LJ, numer shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX.

- Automjeti tip Benz Mercedes E320CDI, me targe AA XXX LG, me numer shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX.

- Automjet tip “Volsäagen Golf”, me targe AA XXX VH, me numer shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX.

- Automjet tip “Fiat”, me targe SH XXXX E, numer shasie ZFAXXXXXXXXXXXXXXXXXX.

- Automjet tip “Mercedes Benz E250TD”, me targe SH XXXX D, me numer shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX.

- Automjet tip “Daimler Chrysler”, C220 CDI, me targe AA XXX AN, me numer shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX.

- Objekt ne proces legalizimi në Shkodër, me Nr. Kodi Unik 10 816XXXX, Nr. 49XX, Nr. Prot. 4970.

- Objekt ne proces legalizimi në Shkodër me Nr. Kodi Unik 10 816XXXX, Nr. 9XXX, Nr. Prot. 9898.

- Objekt ne proces legalizimi në Shkodër me Nr. Kodi Unik 10 8169XXX, Nr. 9XXX, Nr. Prot. 9899.

- Automjet tip “Range Rover Sport”, me targe AA XXX KO, me numer shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX.

- Automjetin tip BMË 320 D, me targe AA XXX GY, me numer shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX.

- Automjet tip BMË 320 D, me targe AA XXX RT, me numer shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX.

- Objekt ne proces legalizimi në Velipojë, Shkodër me Nr. Kodi Unik 10 8169241, Nr. 99xx, Nr. Prot. 9900.

- Objekt ne proces legalizimi në Shkodër me Nr. Kodi Unik 10 816xxxx, Nr. 7861, Nr. Prot. 7861.

- Pasuri Nr. 5xx+1-x, ZK.xxxx, Vol. x, FQ.41, vendndodhje ne xxxxx Shkoder, Plazh, lloji i pasurise Apartament, me siperfaqe 64 m², date rregjistrimi 18.6.2014, me kontrate shitje Nr. Rep/Kol. 1705/xxx, date 10.06.2014.

- Pasuri Nr. 5xx+1-x/1, ZK.xxxx, Vol. 17, FQ.92, vendndodhje ne xxxxx Shkodër Plazh, lloji i pasurise Ndertese, me siperfaqe 73.2 m², date rregjistrimi 25.1.2019, me Leje legalizimi Nr. 704xxxdate 23.11.2018 (*citim*).6

Në kërkesën e depozituar në gjykatë, duke i bashkëngjitur dhe vendimin e gjyqtarit të shqyrtimit të kërkesave të palëve fazës së hetimeve paraprake, rezulton se me kërkesë të Prokurorisë, gjyqtari me vendimin nr.418 datë 17.10.2019 ka vendosur:

“Heqjen e sekuestros preventive të vendosur me vendimin nr. 310 date 25. 06. 2019 të Gjykatës se Shkallës se parë për Krimet e Rënda Tirane, mbi shoqërinë “XXXX XXXXX” shpk ku gjendet edhe “XXXXXXa”, me vendndodhje lagjja buze lumit xxxx, Rruga Qendër,

Shkodër.

- Urdhërohet Prokuroria dhe Policia gjyqësore në varësi të saj të ekzekutojnë këtë vendim” (citim).

Në kërkesën drejtuar gjykatës, prokurori pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar fillimisht bën një përmbledhje të fazës së ekzekutimit të vendimit nr.13 datë 26.09.2019 dhe sqaron se në zbatim të nenit 12, pika (2) të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, të ndryshuar, afati gjashtë mujor i masës së sekuestrimit të vendosur me vendimin nr.13 datë 26.09.2019, për pasurinë shoqëria “Xxxx” shpk ku përfshihet XXXXXXa, ndërtesa si dhe automjetet e kësaj shoqërie, fillon në datën 11.11.2019, datë në të cilën ka filluar të zbatohet vendimi nr. 13 datë 19.12.2019 (automjetet me targë AAXXXFB, AAXXXRF). Gjithashtu parashtrohet se për pasuritë e paluajtshme të sekuestruara me vendimin nr.13 datë 26.09.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, Tiranë, afati i sekuestros vazhdon të jetë i pezulluar pasi të njëjtat pasuri janë të sekuestruara edhe për efekt të sekuestros preventive të vendosur me vendimin nr.310 datë 25.06.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, Tiranë. E njëjta gjë thuhet edhe për pasuritë e luajtshme automjete me targë AA XXX VH, AA XXX LJ, AAXXXLG, AAXXXTR dhe AAXXXGY.

Prokurori argumenton se lind nevoja për zgjatjen e afatit të sekuestrimit për të cilat gjykata është shprehur me vendimin nr.13 datë 26.09.2019, konkretisht shoqërinë “XXXX” shpk dhe pasurive të saj për të cilat zbatimi i vendimit ka filluar më datë 11.11.2019.

Si argumenta në mbështetje të kërkesës drejtuar gjykatës, prokurori parashtrohet:

“ Gjatë fazës së hetimeve pasurore në lidhje me këtë procedim pasuror janë kryer një sërë veprimesh verifikuese pasurore në lidhje me pasuritë në zotërim të shtetasve në ngarkim të të cilëve është regjistruar procedimi pasuror dhe nuk është bërë e mundur që të që të përfundohen hetimet brenda afatit gjashtë mujor.

Konkretisht, nga organi procedues, duke marrë në konsideratë edhe ndryshimet e kryera në ligjin nr.10192 datë 03.12.2009, është vendosur kryerja e ekspertimit vlerësues i pasurive në zotërim të shtetasve A.B, I.K, A.K, A.E, E.E etj. Gjithashtu vazhdojnë verifikimet pasurore në drejtim të shtetasve A.D etj. Lind e nevojshme edhe kryerja e një ekspertimi kontabël me qëllim për të verifikimin e të ardhurave e ligjshme dhe shpenzimet e kryera në lidhur me përfitimin e këtyre pasurive të paluajtshme. Deri në këtë moment procedural ende nuk janë kryer dy ekspertimet e mësipërme, ku aktet e ekspertimit vlerësues dhe kontabël në këtë rast janë dy prova thelbësore prej të cilave do të mund të përcaktohet përfundimisht nëse pasuritë në janë ose jo me prejardhje të ligjshme.

Gjithashtu jemi në pritje të ekzekutimit të letërporosisë nga autoritetet daneze dhe norvegjeze të drejtësisë me qëllim që të merren të dhëna apo indicje në lidhje me veprimtaritë kriminale të personave në emër të të cilëve është regjistruar procedimi pasuror.

Për shkaqet e mësipërme është e domodoshme që për pasuritë te cilat janë sekuestruar me vendimin nr.13 datë 26.09.2019, dhe ndaj të cilave nuk ka efekt pezullimi i vendosur po me këtë vendim (për shkak të sekuestros preventive), të zgjatet afati i masës së sekuestrimit për

një periudhë prej gjashtë muaj (citim).

II. Vlerësimi i gjykatës

- Lidhur me kompetencën lëndore dhe funksionale

Kjo gjykatë, paraprakisht konstatoi kompetencën lëndore dhe funksionale për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Sikurse rezultoi, procedimi pasuror në fjalë ka qenë i regjistruar nga Prokuroria për Krime të Rënda dhe ka vijuar hetimi nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Gjithashtu kjo e fundit vijon hetimin dhe lidhur me procedimin penal ndaj shtetasit nën hetim A.B si i dyshuar për veprat penale “Trafikimi i narkotikëve” “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të kryera në bashkëpunim në kuadër të një grupi të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 283/a, 287, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

Referuar dispozitës kalimtare të ligjit nr.70/2017 që ka ndryshuar ligjin nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pikës 5 të këtij neni, *me krijimin e Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë, transferohen në këtë prokurori dhe në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm sipas kompetencës lëndore për veprën penale të kryer, në bazë të nenit 75/a të K.Pr.Penale.*

Rezultoi se më **datë 19.12.2019** ka filluar funksionimin Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda **është emërtuar** Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Duke interpretuar drejtëpërdrejtë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, pikën 8 të nenit 179, rezultoi jo shkrirja e Gjykatës për Krime të Rënda dhe asaj të Apelit, **por vijimësia**, pas emërimit të gjyqtarit (qoftë dhe të përkohshëm) në Gjykatë të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Konkretisht pika 8 parashikon: ***“Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda do të emërtohen, funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit”***

Rezultoi se është marrë vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” nr.286 datë 18.12.2019. Vendimi është marrë në mbështetje me nenet 135 pikat, 1 dhe 2, 147, pika 1, neni 147/a shkronja “ë”, neni 179 pika 8 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 62 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, neni 15 pika 4, shkronjat “c” dhe “ç”, nenin 22 dhe nenin 83 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenin 57 të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Referuar këtij vendimi, ***Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Krime të Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.*** Me vendimin nr. 299 datë 18.12.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka caktuar në pozicion, në mënyrë të përkohshme, në këtë gjykatë gjyqtaren Miliana Muça dhe vendimi 136 datë 16.04.2020 “Për caktimin në pozicion në mënyrë të përhershme në Gjykatën e

Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Po më datë 19.12.2019 ka filluar funksionimin Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Neni 75/a gërma b) parashikon në kompetencë të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar *çdo veprë penale të kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur.*

Kompetenca lëndore e Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjen rregullim dhe në nenet 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ku neni 8 *parashikon kompetencën lëndore parësore, të rregulluar në nenin 75/a të K.Pr.Penale, në lidhje me nenin 135/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.* Ndërsa neni 9 parashikon se *Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Prokuroria e Posaçme kanë kompetencë për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo veprë penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji.*

Nga kërkesa e prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, rezulton se në rastin konkret hetimet vijnë për vepra penale, dyshuar si të kryera në kuadër të një grupi të strukturuar kriminal (trafikim narkotikësh) dhe kjo bën kompetente Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pasojë kompetente Prokurorinë e Posaçme pranë saj. Në këto kushte, referuar dhe dispozitës kalimtare të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të sipërrajtuar, duke qenë se ***Prokuroria e Posaçme gëzon kompetencën lëndore për ushtrimin ndjekjes penale për veprën penale të kryer, në bazë të nenit 75/a të K.Pr.Penale, po ajo mbetet kompetente për çështjen në hetim pasuror.***

Gjyqtari i shqyrtimit të kërkesave të palëve në kuadër të këtij procedimi pasuror, sikurse është dhe kërkesa objekt gjykimi, vijon të jetë i njëjti, përse kohë që, sikurse u arsyetua më lart, jemi në kushtet kur Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe gjyqtarja Miliana Muça është caktuar në pozicion, në mënyrë të përhershme në këtë gjykatë.

Në këtë mënyrë dhe kompetenca funksionale, që lidhet me mënyrën e caktimit të gjyqtarit/gjyqtarëve në një çështje konkrete (kompetenca e bazuar në llojin e veprimeve procedurale apo me kompetencën brenda gjykatës), ***i përket po këtij trupi gjykses*** (monokratik).

- Lidhur me themelin e kërkesës

Kjo gjykate çmon se kërkesa për zgjatjen e afatit të sekuestros është e bazuar në ligjin e posaçëm nr.10192, date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe si tillë duhet të pranohet.

Neni 12 i këtij ligji, i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017 parashikon:

“1. Kërkesa për sekuestrimin e pasurisë shqyrtohet nga gjykata, me pjesëmarrjen e prokurorit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes, në bazë të dokumenteve të paraqitura prej tij.

2. Vendimi për masën e sekuestrimit është i ekzekutueshëm me shpalljen e tij. Masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar nga momenti i zbatimit të saj.

3. Në rastin e verifikimeve komplekse, me kërkesë të prokurorit ose kryesisht, gjykata mund të vendosë zgjatjen e afatit të zbatimit të masës së sekuestrimit për periudha gjashtëmujore, por jo më shumë se një vit nga data e mbarimit të afatit të masës së sekuestrimit, sipas pikës 2 të këtij neni. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim gjykatën e apelit”.

4. Jo më vonë se 5 ditë përpara mbarimit të afatit kohor të masës së sekuestrimit, të parashikuar në pikën 2 ose 3 të këtij neni, gjykata cakton një seancë të posaçme, duke njoftuar prokurorin, personat e përmendur në nenin 3, pikat 1 dh 2 të këtij ligji, si dhe mbrojtësin e zgjedhur. Kërkesa e prokurorit për revokimin e sekuestrimit, nuk e pengon gjykatën të vendosë konfiskimin e pasurisë kur ajo çmon se plotësohn kriteret e parashikuara në këtë ligj”.

5. Kur seanca posaçme, sipas pikës 4 të këtij neni nuk caktohet, gjykata, me kërkesën e palëve ose kryesisht, konstaton shuarjen e masës së sekuestrimit. Mosparaqitja e kërkesës, sipas pikës 5 të këtij neni, passjell shuarjen e masës së sekuestrimit. Shuarja e masës së sekuestrimit nuk pengon paraqitjen dhe pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë”.

Nga interpretimi logjik i pikave të këtij neni, rezulton se gjykata me kërkesë të prokurorit, apo dhe kryesisht, mund të vendosë jo më vonë se pesë ditë përpara mbarimit të afatit, zgjatjen e afatit të zbatimit të sekuestrimit në rastin e verifikimeve komplekse. Nëse gjykata, nuk gjendet përpara një kërkesë nga prokurori për zgjatjen e afatit të sekuestrimit (qoftë për herë të parë apo dhe pas kalimit të afatit të zgjatur) apo nuk vlerëson qoftë dhe kryesisht ta zgjasë afatin e zbatimit të sekuestrimit, atëherë ajo vepron në përputhje me pikën 4, duke planifikuar një seancë të posaçme me pjesëmarrjen e palëve dhe këtë duhet ta planifikojë jo më vonë se pesë ditë përpara mbarimit të afatit të sekuestrimit apo dhe afatit të zgjatur të sekuestrimit në përputhje me pikën 3.

Bëhet kjo analizë, pasi prokurori në kërkesën drejtuar gjykatës, referon si në pikën 3 ashtu dhe në pikën 4 të nenit të mësipërm, por në fakt kërkon zgjatjen e afatit të masës së sekuestrimit të një pjese të pasurive të paluajtshme të sekuestruara me vendimin nr.13 datë 26.09.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë dhe jo revokimin e sekuestrimit apo konfiskimin.

Për pasojë nuk jemi përpara një kërkesë për tu shqyrtuar në kuadër të pikës 4 në një seancë të posaçme, por përpara një kërkesë për zgjatjen e afatit të zbatimit të masës së sekuestrimit (e cila mund të bëhet dhe kryesisht nga gjykata) për tu shqyrtuar në dhomë këshillimi, rrethanë kjo që rezulton qartazi nga pika 1 në lidhje me pikën 3 të këtij neni. *Parashikimet e këtyre dy pikave interpretohen nga pikpamja logjike në funksion të përcaktimit të formës së shqyrtimit të kërkesës së prokurorit apo dhe disponimit kryesisht nga gjykata për zgjatjen e afatit të zbatimit të sekuestrimit (në dhomë këshillimi apo në një seancë të posaçme) dhe me*

parashikimin e nenit 12/b të shtuar m ligjin 70/2017 të ligjit. Sipas këtij neni gjykata me kërkesë të palëve vendos revokimin e sekuestrimit të pasurisë përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 12, pra edhe gjatë afatit të zgjatur prej saj për zbatimin e masës së sekuestrimit.

Si konkluzion të interpretimit të mësipërm, shqyrtimi i kërkesës së prokurorit u bë në dhomë këshillimi.

Sikurse rezulton, në pikën 4 të dispozitivit të vendimit 13 datë 26.09.2020 **“Për marrjen e masës së sekuestrimit”**, është vendosur:

“ Urdhërohet pezullimi i pasojave të zbatimit të masës të sekuestrimit, deri në dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e masës së sekuestros, vetëm për ato pasuri për të cilat është vendosur për llogari të procedimit penal sekuestro preventive me vendimin nr. 310 datë 25.06.2019 të Gjykatës për Krime të Rënda”.

Ndërsa në pjesën arsyetuese kjo gjykatë është shprehur: “... pavarësisht faktit që për një pjesë të pasurive për efekt të një procedimi penal është vendosur masa e sigurimit me karakter pasuror e sekuestros preventive, me ndryshimet e bëra në ligjin nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese” me ligjin nr. 70 datë 27.4.2017 ka gjetur rregullim marrëdhënia me procedimin penal. Dhe konkretisht në nenin 5 *parashikohet se procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji dhe të dhënat e marra nga procesi penal përdoren në procedurën e parashikuar nga ky ligj.* Në pikën 3 parashikohet që në rastet kur pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara, sipas këtij ligji, i nënshtrohen, gjithashtu, sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas këtij ligji. Pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo kundër pasurisë” (citim).

Sikurse u pasqyruan më lart rrethanat e faktit, periudha gjashtë mujore e afatit të zbatimit të masës së sekuestrimit për efekt të ligjit të posaçëm nr.10192, date 03.12.2009 për pasurinë shoqëria “Xxxx” shpk, ku përfshihet XXXXXXA, ndërtesa si dhe automjetet e kësaj shoqërie me targë AAXXFB, AAXXRF, fillon në datën 11.11.2019, datë në të cilën ka filluar të zbatohet vendimi nr. 13 datë 19.12.2019 (më heqjen e sekuestros preventive ka filluar procedura e ekzekutimit).

Nga sa më lart, kjo gjykatë arsyeton se afati i masës së sekuestrimit me vendimin nr.13, datë 26.09.2019, mbi pasuritë e mësipërme përfundon me datë 11.05.20.2020 dhe disponimi i gjykatës më datë 04.05.2020, është brenda afatit të parashikuar në pikën 3 të nenit 12, 5 ditë përpara mbarimit të afatit kohor të masës së sekuestrimit.

Kjo gjykatë vlerëson gjithashtu se kemi të bëjme me një hetim pasuror të një natyre shumë komplekse, të shtrirë në shumë pasuri, ndër të tjera dhe mbi aktivitetin dhe pasuritë e një shoqëri tregtare. Lidhur me këtë të fundit, sekuestroja për efekt të ligjit nr.10192, date 03.12.2009 ka qenë e pezulluar pasi ka qenë nën efektin e sekuestros preventive, si masë

sigurimi me karakter pasuror dhe i ka filluar efektet me revokimin e masës së sekuestros preventive me vendimin nr. 418 datë 17.10.2019 dhe zbatimin më datë 11.11.2019. Për pjesën tjetër të pasurive të sekuestruara me vendimin nr.13, datë 26.09.2019, vazhdon efektin pezullimi si masë sigurimi me karakter pasuror.

Në kërkesën e depozituar në gjykatë, prokurori argumenton nevojën për kryerjen e veprimeve të rëndësishme në kuadër të hetimit pasuror, të cilat dhe për këtë gjykatë paraqiten shumë të rëndësishme, veçanërisht ekspertimi vlerësues dhe kontabël dhe ekzekutimi i letërporosisë nga autoritetet daneze dhe norvegjeze të drejtësisë.

Në përfundim gjykata konkludon se kërkesa e prokurorisë pranë kësaj gjykate për zgjatjen me gjashtë muaj të afatit të zbatimit të masës së sekuestrimit duhet pranuar dhe konkretisht për për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, veprimtarinë e personit juridik “XXXX XXXXX” SHPK, me numër Nipti LXXXXXXXXXR, me ortak të vetëm shtetasin A.B, me adresë selie: XX.

Në zbatim të nenit 15 pika 1 te ligjit, gjykata në vendimin e sekuestrimit të pasurise, ka detyrimin të caktojë dhe administratorin, referuar listës se administratorëve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Është caktuar si administrator Z. Skënder Met’Hasani, i cili do të vijojë administrimin e pasurive të sekuestruara.

Në referim te nenit 14 pika 4 të ligjit, vendimi për zgjatjen e afatit të sekuestrimit të pasurisë, sikurse dhe vendimi i masës së sekuestrimit duhet t’i komunikohet subjekteve të parashikuara në këtë pikë dhe ky njoftim kryhet nga policia gjyqësore.

PËR KËTO ARSYE.

Gjykata, bazuar në nenet 12, 14 të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”,

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

2. Zgjatjen e afatit të zbatimit të masës së sekuestros si masë parandaluese me karakter pasuror, e caktuar me vendimin gjyqësor nr.13, datë 26.09.2020, për një periudhë gjashtë mujore, nga data 11.05.2020 deri në datë 11.11.2020, për pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, veprimtarinë e personit juridik “XXXX XXXXX” SHPK, me numër Nipti LXXXXXXXXXR, me ortak të vetëm shtetasin A.B, me adresë selie: XX.

3. Vijimin e administrimit të pasurisë të sekuestruar nga Skënder Met’Hasani, administrator

në Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

4. Urdhërohet sekretaria gjyqësore e kësaj gjykate t'i dërgoje menjëhere dy kopje të këtij vendimi prokurorit Altin Dumani.

5. Urdhërohet policia gjyqësore, oficerët policisë gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Leonard Qorri dhe Altin Curri, t'u njoftojnë personave nën hetim pasuror shtyrjen e afatit të sekuestrimit.

6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

U shpall në Tiranë sot më dt. 04.05.2020.

SEKRETARE
JERINA SKRAPARI

GJYQTARE
MILIANA MUÇA

